

Fejtoni ynë:

DRITA

ETNIA SUEDEZE NË FINLANDË

Në gazetën tonë do të mund ta lexoni në formë fejtoni këtë raport, të shkruar nga Shqiptar Oseku për nevojat e Ministrisë për Informacion të Republikës së Kosovës. Etnia suedeze në Finlandë u bë objekt interesimi edhe në kontekstin e ngushtë shqiptar pas deklaratave për shtyp të Raportueses së posaçme për të drejtat e njeriut në ish-Jugosllavi zj. Elizabeth Rehn, ku u ngrit paralelja në mes të gjendjes së etnisë suedeze në Finlandë me atë të banorësisë shqiptare të Kosovës. Titujt dhe nëntitujt janë të redaksisë. Në mungesë vendi, punimit iu hoqën fusnotat.

Gjatë viteve 1000, 1200 dhe 1300 pason një valë e re e përhapjes suedeze drejt Finlandës, që i ripërtriu resurset e etnisë suedeze në këtë vend. Gjatë kohës së mesjetës, kur Finlanda ishte principatë e Mbretërisë Suedeze, e posaçërisht në kohën e kryqëzatave, Finlanda u bë objekt i një politike koshiente kolonizuese, të përpiluar nga oborri e kisha suedeze.

Drita e bletë për carët e Rusisë

Periudha e zotërimit suedez në Finlandë morri fund më 7-9 korrik 1807, kur u lidh a.q. Aleanca Kontinentale midis Francës, Rusisë e Prusisë. Kjo aleancë, e cila u bë me nismën e Napoleonit, kishte për qëllim mëkëmbjen e një bllokade ekonomike kundër Britanisë së Madhe. Aleanca i dha dritën e bletë Rusisë për veprime kundër suedezeve, të cilët asokohe e përkrahnin politikën britanike.

Në pajtim me këtë aleancë, ushtria ruse i shkeli kufijtë më 1808. Më 1809, pas tri betejave të përgjakshme, Finlanda u kthye në principatë në kuadër të Rusisë cariste. Aleksandri i I-rë, i interesuar për t'i shkëputur lidhjet shekullore të Finlandës me Suedinë, iu afroi finlandezëve autonomi të gjërë. Nëpërmes të reformave arsimore, rusët e ngritën finlandishtën nga e folme e masave në nivel të gjuhës shkollore, gjë që përfundimisht e theu dominancën e elitës së arsimuar suedeze në vend.

Politika ruse e stimulimit të identitetit kombëtar finlandez pati efektin e bumerangut me rastin e LPB. Finlandezët, duke e shfrytëzuar ofanzivën e sukseshme ushtarake gjermane në Frontin e Lindjes më 1917 dhe kaosin pas Revolucionit të Tetorit, arritën t'i shkëpusin Leninin njohjen formale diplomatike.

Etnia suedeze luajti rol aktiv në procesin e krijimit të identitetit kombëtar finlandez dhe të pavarësisë së Finlandës. Madje, mund të thuhet lirisht se ky proces gjeti partizanët e vet më të flaktë në radhët e kësaj etnie.

Pushtimi rus më 1809 e gjeti Finlandën me një elitë të arsimuar, gjuhë e folme dhe e shkruar e së cilës qe suedishtja. Rrjedhimisht, ish-in iluministët nga radhët e kësaj elite, të shkolluar tradicionalisht në universitetin e moçëm në Uppsala, që e përvetësuan të parët mendësinë nacionalromantike të kohës, duke e vënë këtë drejtpërdrejt në funksion të themelimit të kombit finlandez.

Suedezyt afirmojnë Finlandën e pavarur

Eposi madhështor kombëtar i finlandezëve "Kalevala" p.sh. që përnga synimet e veta artistike, iluministe e kombëtare mund të krahasohet me "Lahutën e Malcisë" u shkrua më 1835 finlandisht nga dijetari Elias Lönnrot, suedez etnik; Johan Vilhelm Spellman, një tjetër dijetar me përkatësi etnike suedeze, i formuloi i pari themelet e mendimit politik finlandez sipas parimit të kohës "një origjinë, një traditë, një shtet" dhe e shkroi historinë e parë zyrtare, të bazuar në origjinën e fiseve finlandeze; ndërkaq, dijetari etnikisht suedez Georg Forsman, i pari nga elita e vendit që hoqi dorë botërisht nga suedishtja dhe e shpalli finlandishten gjuhë private të komunikimit, luftëtar me pushkë e penë për lirinë e Finlandës, u shpall më vonë hero i Finlandës me mbiemrin e ri finlandez Yrjö-Koskinen.

Njohja e Finlandës nga dika bolshevikë më 1917 nuk i siguroi vetvetiu vendit ekzistencën si shtet i pavarur. Garnizonet e mbetura ruse e organizuan shpejt e shpejt

DRITA

OPPOSITIONEN HOTAS AV SPLITTRING

Demokratiska partiet vinner val i Albanien. Oppositionen, som hoppar av valet, får stort stöd av omvärlden, senast av OSSE-mötet i Stockholm, men hotas av stor inbördes kris.

Av Shqiptar Oseku

Den 26 maj i år hölls parlamentsval i Albanien, det tredje demokratiska och fria valet i ett land med flertusenåriga anor. Första gången man höll någorlunda fria val i Albanien var det efter omvälvningarna i Öst och det resulterade, föga förvånande, i att kommunisterna bekräftade sin maktställning i det då sista stalinistiska fästet i Europa. Det blev dock en kort och mycket sorglig historia, som efter mer eller mindre direkta påtryckningar från utlandet, och då främst USA, slutade i ett dramatiskt nyval där mittenhögerens demokratiska parti vann över 60 procent av platserna i folkförsamlingen, *Kuvendi Popullor*, och dess ledare, läkaren Sali Berisha, blev landets första demokratisk valde president. Markandsekonomi

Under Berishas ledning har Albanien undergått en radikal förändring från planekonomi mot marknadsekonomi. Landets föråldrade industri har utsatts för mördande konkurrens från utlandet och har numer privatiserats nästan helt, varmed staten blivit av med de absolut tyngsta posterna på utgiftssidan. Genom en strikt åtstramning har regeringen lyckats få bukt med inflationen, som nu ligger på en stabil nivå. Med utlandsalbanska och utländska pengar har man byggt upp ett fungerande bankväsende, som helhjärtat stödjer privata initiativ. Faktum är att vid fjolårets slut visade t.o.m. den förödande arbetslöshetskurvan en tendens att falla, för första gången sedan beräkningen börjat (det stalinistiska Albanien hade officiellt ingen arbetslöshet).

Reformarbetet har dock inte gått smärtfritt till. Samhället genomsyras av jakten efter pengar, varför korrruptionen vuxit oroväckande. Presidenten dr.Sali Berisha är därför idag mindre populär än i början av sin mandat. För att få igenom beslut har han i flera fall tagit till hårda metoder. Hans syften har ifrågasatts av den socialistiska oppositionen, som offentligt beskyllt honom för maktfullkomlighet.

Mycket prestige i valet

Oppositionen avhopp från valet var därför ingen stor överraskning. Båda sidor hade i förväg utropat sig till segrare, vilket gjorde resultatet till oerhörd prestigefråga. Från europeiskt håll, senaste från OSSE-mötet i Stockholm, har man uttalat sig i ovanligt skarpa ordalag om Berishas seger, som i princip avfärdats som valfusk.

Sanningen kan dock vara något krångligare än så. Faktum kvarstår nämligen, att oppositionen ändå hoppade av mitt under valdagen, tre timmar innan lokaler skulle stängas. Det är troligt att regeringssidans arroganta valpropaganda fått folk att avstå från att välja (valdeltagandet var ca 60%) och det kan ha missgynnat oppositionen, men frågan är om den rimligen kan anses som "grava brott mot vallagen".

Det kan helt enkelt ha funnits även andra skäl till oppositionens valförlust än det påstådda valfusket. Den senaste krisen inom socialistpartiet, där partiledaren Fatos Nano, som sitter i fängelse för korrruption, kritiserar (*märk väl!*) PS ledning för att ha överreagerat i samband med avhoppet och där flera tunga namn ur partiledningen avgår tyder på detta.

OSSE har tidigare uttalat sig i mycket försiktiga ordalag i liknande fall, t.ex. efter valen i de f.d. sovjetiska republikerna, där det t.o.m. förekommit blodiga strider inför och under valen. Samma försiktighet vore kanske att föredra även i fallet Albanien, där vändningen mot marknadsekonomi och demokrati av västlig typ ändå har varit fredlig och mer tveklös än annanstans i Östeuropa.

Kosovas informationskontor
Kosova's Information Office

Zyra e Kosovës

Luntnakargatan 66

113 51 Stockholm

Sweden

Tel: (0)8 158405

Fax: (0)8 158405

KIC@KOSOVA.pp.se

Informationsblad
vecka 29, 1996

- | | |
|----|--|
| 3 | Fack utsatt för 33:e polisträd
Oberoende fackföreningars ledning
anhållen - igen |
| 5 | Skola förvandlas till tivoli
Det serbiska våldet mot undervisningen i Kosova fortsätter |
| 8 | Utrotad sjukdom tillbaka
Vårdmyndigheter rapporterar om fler fall av hemorragisk feber |
| 10 | Albansk protest i TV
Grannländer oroade av etnisk spänning i FYROM |

Kanadensisk konsul i Prishtina
Prishtinë 17 juli
Ted Mackay, 1:e Sekreterare vid den kanadensiska ambassaden i Belgrad samt Kanadas konsul i FRJ var på onsdagen på officiellt besök i huvudstaden Prishtina.

DRITA

Mackay fick bl.a. träffa Edita Tahiri, LDK:s ansvariga för utrikesrelation, som informerade gästen om de serbiska hämndaktionerna mot albaner efter gerillan UÇK:s senaste attacker. Mackays albanska värdar bad honom agera för en större internationell närvaro i Kosova, för att förhindra ytterligare förvärring av situationen.
(KIC)

USA-politiker i Prishtina

Prishtinë 18 juli

Kosovas huvudstad Prishtina var på torsdagen värd för Elliot Engel, inflytelserik demokratisk kongressledamot.

Engel fick träffa ledningen för självständighetsrörelsen i Kosova samt ett antal prominenta intellektuella, som breaffade honom om den senaste farliga utvecklingen i landet. Vårdarna bl.a. betäckade Engel för sin engagemang i samband med USA:s beslutet att öppna ett kontor i Prishtina och även allmänt för sin engagemang i Kosovafrågan.
(KIC)

Fack utsatt för 33:e polisträd

Prishtinë 17 juli

Serbiska ockupationsstyrkor utförde på onsdagen sin 33:e razzia mot de oberoende fackföreningarnas lokal, varpå de vandaliserade utrustning, beslagtog handlingar samt tog närvarande fackledare till förhör.

Albansk mark beslagtogs

Klinë 17 juli

Serbiska ockupationsmyndigheter beslagtogs på onsdagen 1500 ha mark från en alban i ortens omnejd, med syfte att bygga bostäder åt serbiska nybyggare. Beslutet har orsakat spänning i området, eftersom befolkningen fruktar fler liknande beslut i framtiden.
(KIC)

Skola förvandlas till tivoli

Ferizaj 16 juli

Serbiska ockupationsmyndigheter installerade förra veckan en mängd tivoliutrustning i lokaler tillhörande en grundskola i orten. En annan grundskola har av serbiska myndigheter redan förvandlats till marknadsplats.

në ditë e në orë të caktuara në fshatëra ku nuk ka bibliotekë dhe bën shpërndarjen e librave për lexim si dhe merr ato të lexuarat.

Nën përkujdesjen time janë edhe këto gjëra në sallë: telefoni, kafeteria, vitrina e librave më reja që është gjithnjë e hapur në sallë, e ku lexuesi mund të blejë libra sipas shijes së vet si dhe fotokopjuesi.

-A mund të na thuani se sa libra në gjuhën shqipe disponon kjo bibliotekë momentalisht?, e pyes këtë puntor të urtë.

- Janë 50 copë. Mirëpo, ne llogarisim se edhe ato libra që janë në Malme, Stokholm, Umeo, janë disponibile për lexuesin tonë, i cili ka mundësi ta bëjë porosinë këtu e pas një jave ta marrë librin që ai e do.

- Sa gazeta ditore suedeze e sa gazeta e periodikë të huaj i parapaguani?

-17 gazeta ditore suedeze dhe 42 gazeta e periodik në gjuhën e huaja, në mes tyre 5 janë në gjuhën shqipe: Rilindja, Zëri i Popullit, Illyria, Besa dhe Drita.

Poezia e zbulon shpirtin e një populli

-A ju ka rënë ndonjëherë të lexoni diç nga letërsia shqipe?

- I kam lexuar me veç disa nga poezi të përkthyer në Besa e Drita. Për aq sa unë kam arritur të lexoj, nuk mund të them se jam i përgaditur të jap një gjykim të pjekur për to. Sepse, të jemi të qartë, përmes poezisë njeriu mund ta zbulojë shpirtin e një populli. Megjithatë, mund të them se poezia shqipe dallohet qartë nga poezia suedeze. Ishin disa tone të panjohura për mua. Posaçërisht ato nga lashtësia e popullit tuaj të vuajtur shumë.

Kur desha të dilja jasht kish filluar një shi rrëke shiu.

U ktheva dhe e pashë Jonyn që m'u kishte afruar me çadër në dorë.

-Urdhëroni çadrën, më tha, se do të lageni.

DRITA

-Falemnderit, po unë nuk banoj larg, prandaj s'ka nevojë sepse do të pres pakëz.

-Duke e parë se unë s'po e kuptojë asgjë, Jony më tha:

-S'keni nevojë të prisni fare. Ne ua huazojmë çadrat lexuesve ashtu si edhe librat. Edhe kjo është ajo strategjia jonë për t'i tërhequr lexuesit.

A don koment kjo?

Ulmar Qvick:

DJAJTË ME FLATRA ENGJËLLORE

Mornicat na kalojnë në trup

Kujtimet nga mizoritë e fashistëve dikur

Masakrat në Bosnjë dhe

Këto na kalli frikën

Sidoqoftë, këtyre djajve ua njohim emrin:

Hitleri, Pol Poti, Idi Amini, Millosheviqi...

Kjo është ligësia e pastër

Bile nga ëndrrat tona të këqija

mund t'i fusim këto mizori në letër

pastaj bëjmë një pllakat të madh

e vendosim mbi mur dhe e shpojme

me thikën e neverisë sonë

Por djajtë me flatra engjëllore

që na hasen në zyrat më të qeta

djajtë burokratik të Suedisë demokratike

të mbushur gjer në grykë me humanizëm

ata janë të paprekshëm, në sferat e tyre

qiellore

me duar të pastra pas vrasjes

Këta janë xhelatët me parime të shenjta

- shtrati i pushtetit të tyre -

që i lejojnë të pushkatojnë njerëz

me revole që nxjerrin nga këllëfët e

e drejtësisë

Dhe këta djaj do të vazhdojnë punën e tyre

Ne do të dëgjojmë gjithmonë

fërfëllimën e flatrave të tyre kur zbresin në

tokë

me revolen e fshehur në këllëf.

DRITA

De senaste månaderna har det t.ex. slagits larm om flera fall av hemorragisk feber, varav flera med dödlig utgång, som drabbat främst boende i landsbygden. Dessutom har en fruktat epidemi bland korna fått till följd att serbiska poliser avlivat nästan hela nötkreaturbeståndet i stora områden av landet, vilket ytterligare förvärrat situationen för landsbyggdsbefolkningen.

Vårdmyndigheter utpekar Belgrad som skyldig till den drastiska försämringen av folkhälsan i landet. Tiotusentals albanska läkare och övrig vårdpersonal avskedades och hundratals vårdinrättningar stängdes av serber i samband med ockupationen av landet 1989-1990. (KIK)

Polisen griper studentledare

Pristinë 17 juli
Tungt beväpnade serbiska ockupationsstrupper greps på onsdagen Atdhe Hykolli (27), ordförande i filologiska fakultetens studentkår. Hykolli fördes till en lokal polisstation, där han förhöordes under tortyr om sin verksamhet inom kåren.

Serbiska ockupationsmyndigheter har på senare tid intensifierat sin förföljelse mot albanska utbildningsanställda och studenter, som man menar är anhängare till gerillan UÇK. (KIC-KIK)

Albansk protest i TV

Zagreb 15 juli
Kroatisk TV visade på måndagen en längre reportage om det stora albanska protestmötet i Makedonien, som ägde rum tisdagen den 9 juli. Liknande program visades även i Bulgarien, Grekland, Turkiet, Serbien, Albanien och Slovenien.

Bilderna visade tiotusentals förargade albaner som samlats för att protestera mot diskriminering i Makedonien och för att kräva rätten att utbilda sig i sitt språk.

Den albanska ursprungsbefolkningen utgör en tredjedel i FYROM och känner sig diskriminerad av landets slaviska befolkning. FYROM:s grannländer är oroad över den tilltagande spänningen och har genom internationella instanser ofta bett makedoniska myndigheter att tillmötesgå albanernas krav.

DRITA

- Suedia tek në ato vite, nën udhëheqjen e ekuilibruar të Ulof Palmes, u afirmua më së shumti në botë, si një vend paqësor dhe kështu e krijoj një imigj që e patën lakmi bukur shumë vende, thot Jony duke mos e fshehur simpatinë e krenarinë për Palmen. Jony vazhdon:- Palme pati vizion të qartë po edhe që trim! Nuk iu frikësua Amerikës- e dënoi ashpër luftën e Vietnamit (i vetmi burrë shteti që doli në demonstrata së bashku me qytetarët e tij kundër kësaj lufte!) por as Bashkimit Sovjetik, të cilin vend e dënoi poashtu shumë ashpër pas okupimit të Çekoslovakisë, ndonëse Bashkimi Sovjetik ishte përbri nesh, pra fqinj!

-Eh, ofshanë Jony për kujtimet e rinisë së vet dhe vazhdon t'i kthehet temës për të cilën ia filluam bisedës.



Jony Mortenson

Llojet e bibliotekave dhe sekcioneve

-Pra, tek ne janë këto lloje shkollash për bibliotekari, thot ai dhe fillon t'i numërojë:

1. Biblioteka Popullore (si kjo jona);
2. Biblioteka e hulumtimeve shkencore;
3. Biblioteka e ndërmarrjeve.

-Unë e kam për detyrë që të bëjë hulumtimin e e nevojave të lexuesve invalidë, spitaleve dhe bibliotekave të puntorive e fabrikave, kurse këtu, në këtë bibliotekë, thot Jony, ne i kemi disa sekcione:

1. Libra dokumentarë (Historie, memoarje)
2. Literatura artistike
3. Sekcioni i fëmijëve dhe rinisë
4. Sekcioni i të huajve: llojloj librash
5. Gazeta dhe periodikët
6. Librat folëse- janë për të verbërit
7. Filjalat në katër fshatëra dhe një në spital
8. Biblioteka lëvizëse - Libërbus, i cili shkon

gadi 200 vite që s'kemi luftuar, prandaj poetët tanë janë dhënë më shumë ndaj poezisë meditative. Andaj, me gojë plot pohoj se poezia juaj është një freski për ata suedezë që kanë rast ta lexojnë.

Ndërsa ishim duke biseduar, befaz cingërroi telefoni dhe, fytyra e Kristianit morri pamje serioze.

-Më vjen keq, por më duhet të shkoj urgjent në komunë. Kam një vizitë të paralajmëruar nga Stokholmi në zyrën e komunës. E di ti, m'u drejtua Kristiani me një zë miqësor, unë vazhdoi ai, jam 70% i punësuar në komunë si shef i kulturës për Trelleborg dhe, veç 30% jam i punësuar në këtë bibliotekë.

U përshëndetëm, duke e lënë që takimin e ardhshëm ta caktojmë përmes telefonit.

Më kishin ngelur edhe dy a tri pyetje.

Ulof Palme që një politikan i ekuilibruar

Kur po zbrisja shkallëve të katit të dytë, takova Jony Mortenson, tashmë miku im. Këtëj njeriu kish më se dy vite që iu kisha lutur që të bënte parapagimin e Rilindjes, të cilën gjë ky edhe pat kryer brënda një kohe shumë të shkurtër. Aty për aty vendosa të vazhdoja me pyetjet e ngelura.

Në fillim ngurroi pakës. Kur i thash se kjo është për gazetën Drita, të cilën e dija se ky e lexon, Jony tha:

- Okej dhe, u kthye për të gjetur një lokal ku mund të zhvillonim bisedën pa pengesa.

Jony është i 46 vjeçar dhe është në bashkëjetesë me një grua, e cila i ka dy djemë. Ka studjuar dy vite pranë Universitetit të Lundit ku ka mësuar filozofinë, teknikën, medicinën historinë literaturën sociologjinë. Pastaj ka vazhduar dy vite në Shkollën e Lartë të Bibliotekarisë në Boros. Para dhe gjatë studimeve Jony ka qenë i ndikuar nga ngjarjet revolucionare të asaj kohe si lufta në Vietnam, demonstratat e studentëve në Evropë por edhe revolucionit paqësor i Dubčekut në Çekoslovakia i cili dështoi nga cari i kuq, Brezhnëvi.

DOKUMENTE=

DRITA

VARIANTË E SHKURTUAR E PROJEKTIT TË FONDACIONIT TRANSNACIONAL SUEDEZ PËR PAQË

Jan Öberg është drejtor i këtij Fondacioni pranë Universitetit të Lundit(Suedi). Projekti i këtij shkencetari dhe humanisti është i shtypur në 50 faqe dhe në të janë të dhënë pikpamjet e Kosovës dhe Serbisë rreth zgjidhjes së çështjes së Kosovës. Nëse kjo nuk bëhet, dhuna me siguri do të përfshijë edhe atë rejon më të varfër të Evropës, mendon Öberg. Meqë ga-zeta Drita shpërndahe në tërë Evropën dhe SHBA e Australi, po e japim këtë Projekt të shkurtuar në gjuhën angleze.

A CIVILIAN UN AUTHORITY FOR A NEGOTIATED SETTLEMENT IN KOSOVO

The Transnational Foundation proposes the establishment of a civilian United Nations, or other international, Temporary Authority for a Negotiated Settlement, UNTANS, Serbia's Kosovo province.

It aims to facilitate, in a context of order, safety and respect for human rights, a peaceful and longterm negotiated settlement of all conflict issues between Serbia and the Federal Republic of Yugoslavia on the one hand and the Albanian population in the region of Kosovo on the other.

The Authority shall take over parts of the administration of the Territory, Serbian as well as Albanian, for a period of up to three years and provide a Professional Negotiation Facility composed of persons experts and with practical experience in conflict and dispute mitigation.

All military and para-military forces not deemed necessary for self-defence shall be replaced with Civil Police and monitors in the territory. Skilled multi-ethnic and multi-cultural Civil Affairs Officers are deployed together with qualified civilian volunteers from non-governmental organizations to monitor the UNTANS's support among the inhabitants, serve as neutral "Third Party" mediators and instill trust. Peacebuilding, such as the teaching conflict understanding, negotiations and settlement, is an integral part of the Authority.

This new type of international conflict management is not a protectorate. By refraining from stipulating what the final settlement should look like, it respects the rights of conflicting parties to search for their own solutions. It seeks to facilitate such a process by nonmilitary means. Thus, it is violence-prevention and principled, professional negotiation in one.

The proposal has been developed through the Transnational Foundation's analyses and informal mitigation efforts during 7 missions to both sides since 1991. The proposal consists of a draft treaty text with comments by the parties and the TFF and, thus, presents an indirect dialogue between the highest authorities on both sides — the first of its kind.

The Dayton Agreement has changed the conflict landscape also outside Bosnia. We appeal to actors in the international society to act creatively and in time. We are convinced that the parties do not want an escalation of uncontrolled violence but that it could anyhow happen. The UNTANS proposal is based on the belief that only through negotiations can the parties and the international society hope to avoid the worst and aspire to achieve the best.

The UNTANS concept is generally applicable to other conflicts, as an alternative to military or otherwise externally-imposed solutions.

Acquaint yourself with the full proposal

UNTANS. Conflict Mitigation for Kosovo

Memorandum of Understanding between the UN and the Federal Republic of Yugoslavia concerning a United Nations Temporary Authority for a Negotiated Settlement in Kosovo.
TFF, Lund Sweden 1996, 36 pages, 75 Swedish kronor or US\$ 12 plus postage.

T F F

TRANSNACIONAL FOUNDATION FOR PEACE AND FUTURE RESEARCH
Vagagatan 25, S - 224 57 Lund, Sweden
Phone + 46 - 46 - 145909 (9:00-10:00 and 14:00-16:00) Fax + 46 - 46 - 144512 (24 h)
E-mail: Internet Jan.oberg@mailbox.swipnet.se ~ APC pns:joaberg ~
Others Joeberg@nn.apc.org

6

DRITA

Po, vazhdoi Kristiani, unë nuk jam i sigurt se Ju e dini edhe një dukuri që është me interes ta dinë bashkatdhetarët tuaj:të gjithë fëmijëve të sapolindur u dhurohet nga një libër nga bibliotekat tona. E poash-tu secili fëmijë, i cili i mbush 6 vite, përme: çerdhes i dhurohet një libër.

-Luteni të na thueni mënyrën se si ko-munikoni me lexues?

-Në bibliotekën tonë është një kompjuter i vendosur në sallën e leximit, në të cilin çdo lexues mund t'i lexoj tituj e librave e poash-tu emrat e shkrimtarëve. Aty është i vendosur disketi me listën e librave për tërë vendin. Përveç kësaj, i shtypim në shtypshkronjën tonë: broshura të ndryshme; informata për librat e ndryshëm pastaj e kemi kutin postale që është në bibliotekë e ku secili lexues mund të na shkruaj se çfarë i pëlqen dhe çfarë s'i pëlqen tek ne.

Kadare më ka mahnitur

Para se të ndahemi me Kristianin ia shtruam atij edhe një pyetje që na u duk me rëndësi për lexuesit tonë.

- Ju lutem, na thuani se a keni lexuar diç nga letërsia shqipe?

- Si jo? u përgjigj duke e tundur kë-në në shenj habie për pyetjen që po i shtroja. Unë, tha ai, njërin nga shkrimtarët që e çmoj më së shumti është Kadare. Te Kadare aroma e pikëllimit është e pranishme gadi më shumë se askund tjetër. Ju e keni pasur fatin që keni një shkrimtar të tillë të madh e që ju përfaqëson kudo në botë. Përmes Kadaresë e kam më të afërt botën tuaj. Jam i mahnitur nga ai. Por, kë-tu na vijnë edhe Drita e Besa, në të cilat revista unë i kam lexuar me ëndje poezitë e bukura shqipe të përkthyer në gjuhën tonë. Në to më tepër mbretëron fryma luftarake, epike. Ne suedezët i kemi lënë prapa

përmendur, thot ai, se kompletimi i bibliotekave bëhet tek ne ndryshe nga mënyra klasike e kompletimit. Tre qendrat më të mëdha të vendit: Stokholmi, Malme dhe Umeo janë ato që i furnizojnë të gjitha bibliotekat e tërë vendit. Pra, ai libër që gjendet në Veri të Suedisë mund të gjendet në duart e lexuesit në Jug të Suedisë brenda pak ditësh. Me fjalë të tjera, kjo bën të mundëshme qarkullimin e librave në mënyrë të tillë që çdo bibliotekë e një qyteti apo fshati t'i ketë po ato libra që i ka Stokholmi ose secili qytet tjetër kudo qoftë në Suedi.

-E nëse nuk ekziston libri në fjalë në asnjërin nga këto biblioteka, e pyeta me kërkshëri Kristianin, çdo të ndodhë?

-Nëse një njeri e kërkon një libër që nuk është këtu ne i drejtojmë kërkesën Malmes, meqë është qyteti më i afërm nga ne pastaj, nëse aty nuk është, Malmeja do ta kërkojë në Stokholm ose Umeo. E po që se as atje nuk gjendet, do të porositet në bibliotekat ose libraritë e tërë botës! Është devizë që nuk shkelet lehtë - e drejta e lexuesit është të kërkojë librin, jona t'ia sigurojmë.

Të posalindurit i dhurohet një libër

-Po, sa libra janë të tilla që, megjithatë, konsiderohen pronë e e bibliotekës suaj, e pyetëm Kristianin.

-Të tilla janë veç 60.000 mijë copë.

-A nuk është kjo shifër e vogël për t'ia plotësuar dëshirën çdo lexuesi, e pyes unë. Kristiani buzëqeshi lehtas dhe shtoj:

-Veç në vitin e kaluar lexuesit tonë i kanë huazuar mbi 274.000 mijë libra. E ne nuk i kemi të gjitha këto. Ne e bëjmë huazimin nga bibliotekat tona siç e shpjegova më parë.. Mesatarja e librave që huazohen është 7 copë për kokë të banorëve të Tre-leborgut, i cili i ka dikund afër 35 mijë qytetarë.

31

DRITA
PËR LEXUESIN - LIBRAT NGA E TËRË BOTA

Reportazhi kulturor: Biblioteka

Si funksionon biblioteka suedeze? Luhet shahu në rrugë për t'i joshë lexuesit! Detyra primare e bibliotekës - ta gjej librin! Ç' thot drejtori i bibliotekës së Trelleborgut për Kadarenë dhe për poezinë shqipe? Ç'mendojnë dy përgjegjësit e bibliotekës së Trelleborgut për poezinë shqipe?

Shefki Oseku:

Kudo në Suedi, po edhe në këtë qytet, biblioteka është njëra nga institucionet me frekuencë më të madhe nga qytetarët. Është e njohur e dhëna se suedezët janë populli që më së shumti investojnë për kulturë, e ku vendin me të rëndësishëm e ka shtypi ditor, apo edhe ai javor e peri-odik. Me qëllim që populli të jetë i informuar sa më gjithanshëm për proceset shoqërore-politike e kulturore në vend dhe në botë, ndahen një pjesë e madhe e buxhetit shtetëror për të arritur synimin e cekur më lartë. Na duket e panevojshme të cekim se ky është edhe investimi më i mirë për të ardhmen e një vendi.

E qartë për gjithkë.

Shahu në rrugë - për t'i joshë lexuesit

Për të pasqyruar në mënyrë sa më besnike atë që e thamë më lartë në fillim të korrikut bëmë një intervistë me drejtorin e bibliotekës së Trelleborgut Kristian Jiselkuist dhe me përgjegjësin e Veprimtarisë Kërkimore, Jony Mortenson.

Mirëpo, para se të hynim në bibliotekë, në platonë e saj, ishin tubuar disa njerëz e po luanin shah rrugë. Tek më vonë do të kuptoj se kjo është pjesë e veprimtarisë së përditshme të bibliotekës gjatë sezonit veror. Biblioteka kujdeset për t'i joshë lexuesit edhe me kësi lojëra shahu në rrugë!

Drejtori Kristiani është i moshës 51 vjeçare dhe është baba e besa edhe gjysh i dy vogëlushve. Është i lindur në Gëteborg ku ka studjuar në Shkollën e Lartë të Bib-

liotekarisë dhe ku ka magjistruar. Por, ashtu si shumica e suedezve që nuk e plakin jetën në një vend, edhe ky u punësua në Piteo, në Veri të Suedisë, ku punoi dhjetë vite. Tek në vitin 1984 vie në Trelleborg, në po këtë vend pune që e ka edhe sot.

Gjatë bisedës disa orëshe, Kristiani na shpjegoi se bibliotekat në Suedi, së pari në Gëteborg, më 1910, e pastaj në tërë vendin kanë filluar të punojnë si të hapura, dmth. ku lexuesi lirisht shkon nëpër raftat e bibliotekës dhe i zgjedh librat sipas dëshirës së vet, me përjashtim të atyre librave që janë exemplarë shumë të shtrenjt ose që nuk mund të gjenden në shitje. Kjo u tregua si një metodë joshëse për lexuesit, sepse tek kështu mundësia e zgjedhjes së tekstit të preferuar u bë më e afërt se kurrë më parë.



Kristian Jiselkuist

Detyra e bibliotekës - ta gjej librin!

Duke folur mëtutje për organizimin e bibliotekave anë e kënd Suedisë, Kristian thot se çdo qytet është i detyruar për kompletimin e bibliotekës së vet. Mirëpo, duhet

DRITA
DOKUMENTE

Në fillim të vitit 1990 Serbia i helmoi me gazëra nervor mbi 7000 nxënës e fëmijë shqiptarë në shkolla e çerdhe. Shtrohej pyetja-a ua kemi bërë të njohur botës këtë fakt tronditës? Tani, përmes dokumenteve që i ranë në dorë Dritës, shofim se kjo dilemë s'ka vend fare!

His Excellency Mr. Boutros Boutros GHALI
Secretary General United Nations
New York

Concerns: wargases-toxicology
post-mortem. autopsy

Excellency,

Referring to my letter-reports of February 17th, and February 27th 1995 to your office, I mention again the chemical gas Sarin used by the Serbs in Kosovo, and the big intoxications on civilians, mothers and children (my report 1-5 July 1990, dated August 10, 1990 : Bosnia-Herzegovina).

This time the Federal Serb Army has been discovered by a British officer in their factory at Potoci east of Mostar. The sample was analysed in Sweden (SNDE) as Sarin, the wargas we detected earlier, and was so confirmed. This wargas was exported to Irak to Samara. Chemical gas used against the Kurds and also in Iran (see my previous reports Irak-Iran chemical warfare).

In my published scientific toxicological studies (Halabja, Angoia, Bhopal, etc.) we found that those gases remain in dead bodies, buried, a very long time (anaerobic state); once exhumed the gas decomposes. By the autopsy, one should be very careful not to be contaminated, enclose the samples quickly and analyse directly. Otherwise the results will be negative. This was also the case in Tokyo (Sarin Metro cases) and others. The forensic pathologists and toxicologists should be very careful. Those gases are much more stable than one thinks in post-mortems.

Experience had taught us that also in Rumania (Sibiu), where we investigated also the watertowers, poisonings by Sarin (Christmas 1989), and the dead bodies found in the Central Hospital killed by the Securitate.

Will you possibly investigate these terrible problems. More toxic compounds : chemical and biological are in the hands of Irak.

Sincerely yours,



Prof. Dr. A. HEYNDRICKX

Kopje e letres autentike të shkruar nga një ekspert i OKB nëpërmes të cilit vërtetohet se Boutros Ghali ka patur tërë kohës dijeni për helmimet në Kosovë.

Kopia av FN-experts originalbrev som bekräftar att FN:s generalsek. Boutros Ghali hela tiden haft personlig kännedom om serbernas användning av nervgas mot albaner i Kosova.

- vijon në numërin e ardhshëm-

DOKUMENTE=

Me dt. 30.07.96 në ora li.10 në emisionin në gjuhën shqipe të Radios Suedeze, Ditari u dha emisioni me titull "A ka dështuar politika paqësore e kryetarit të Kosovës, Dr. Ibrahim Rugova"? Në këtë emision folën (me telefon) Hydajet Hyseni, Arbër Vllahu, Simon Augustini, Bajram Kosumi, Afrim Morina.

Pjesa e dytë e këtij emisioni pati të bëjë me Adem Demaçin dhe polemikat që i ka shkaktuar në Kosovë moszgjedhja e tij anëtar i Parlamentit të Kosovës si dhe propozimi i tij për krijimin e një konfederate ballkanike.

Po i japim disa fragmente nga këto dy tema të nxeta verore të Kosovës.

PJESA E PARË: A ka dështuar Dr. I. Rugova?

Arbër Vllahu: Rezistenca paqësore e shqiptarëve në Kosovë, sipas pohimeve gjithnjë e më të shpeshta të udhëheqësve të tyre është e vetmja rrugë që përkrahet nga bashkësia ndërkombëtare, ndonëse ajo ende mbetet mes suksesit dhe dështimit... Komentimet për këtë rrugë të zgjedhur kanë marrë kahje të ndryshme.

Për Partinë Shqiptare Demokristiane... rezistenca aktuale është e paalternativë.

Simon Augustini: ...rezistenca paqësore... është e vetmja rrugë në këto rrethana, në këto kushte që janë krijuar...kjo rrugë pranohet nga qarqet e vendosjes në botë.

Bajram Kosumi: kryetar i Partisë Parlamentare të Kosovës: Ka forma të llojlojshme të aktivizimit të rezistencës... duhet të krijohet hapsirë që të dal në skenë energjia shqiptare dhe do të habitemi se aq shumë forma e aq shumë mënyra të rezistencës dalin në sipërfaqe...kjo do të përkrahet prej bashkësisë ndërkombëtare, absolutisht! Gabojnë ata që thojnë se nuk do të përkrahet!...

Afrim Morina: nënkryetar i Partisë së Unitetit Kombëtar: Rezistenca paqësore në Kosovë në dy vitet e para ka pasur efektin e vet por ajo është shterrur sot.

Hydajet Hyseni, nënkryetar i LDK-ës: (i numëron katër arsye- shënim i Redaksisë!) 1. Sepse, duke aspiruar lirinë e vërtetë, që nuk është robëri për të tjerët... ne nuk kishim nevojë për dhunë...; 2. Sepse rruga paqësore është në thelb mbizotëruese në gjithë traditën tonë...; 3. Sepse në rrugën paqësore shqiptarët kanë përparësi të shumta, shfrytëzimi i të cilave u mundëson realizimin e aspiratës së tyre supreme dhe neutralizimin, mundjen e përparësisë së vetme që eventualisht mund ta ketë kundërshtari, atë në planin e forcës së armëve; 4. Sepse duke qenë në përputhje me proceset demokratike e integruese. Shqiptarët kanë qenë të bindur mbase pak tepër të bindur! dhe kanë besuar mbase pak në mënyrë naive se rruga e tyre paqësore...do të mirëkuptohet nga bashkësia ndërkombëtare, dhe nga vet forcat demokratike në Serbi...

PJESA E DYTË : Demaçi iu përgjigjet pyetjeve të Zërit të Prishtinës

Milaim Zeka, gazetar i Radio Stokholmit, emisioni Ditari në gjuhën shqipe: Tanimë është bërë shprehje që në shtypin shqiptar...të flitet çkamos e të thuhet gjithçka për njerëz, të cilët gjatë gjithë jetës së tyre janë dëshmuar se kanë luftuar për të mirën e popullit të tyre. Flitet edhe për Adem Demaçin, njeriun i cili plot 28 vite të jetës së tij i kaloi nëpër burgjet më të egra të ish Jugosllavisë. Pra një kohe, Demaçi duke e parë gjendjen momentale të shqiptarëve, doli me një ide për krijimin e një konfederate të quajtur Ballkania. Lidhur me këtë dhe problemet e tjera Adem Demaçi në Revistën Zëri të Prish-

RIZA SHEQIRI:

Letër e hapur vëllaut të dhembjes kurbetçare

Sa para paguan në kafene, bare, klube, për veturë, telefonin...sa harxhon për familjen tënde e sa për atdheun, i cili po vuan nën thundrën e pushtuesit barbar?

Ti për Atdheun çfarë ke bërë ?

Nëse nuk i ke bërë, të lutem sapa ta përfundosh këtë artikull së lexuari, hyrju këtyre llogarive e do ta shohësh vetveten ku je. Do ta kuptosh fare mirë se në ç'gjendje ke shkuar. Atëherë do të turpërohesh para vetvetes, para fëmijëve tu, familjes tënde, para dashamirëve, bashkëvendasëve e bashkombasëve tu. Atëherë do të turpërohesh për pyetjet që i bënë shpesh nëpër kafene kur je pakëz i nxehur: "Po ç' bëri atdheu për ne!?" dhe vëllau im i dhembjes kurbetçare atëherë do ta shohësh vetveten se ku je, do të turpërohesh para vetvetes e para atdheut, sepse atdheu s'paska bërë kurgjë për ty, po ti për atdheun çfarë na paske bërë, sa kohë paske harxhuar, sa para e sa mund paske shpenzuar ti për atdheun i dashuri im vëllau i dhembjes kurbetçare. Ti s'e ke përmbushur as atë obligimin më të vogël, atë obligimin ultra minimal që atdheu ta ka parashtruar (obligimin e trepërqindëshit) e lere më tjetër. Si s'të vjen turp kur shkosh në postë a në bankë me gjithë ato fletëpagesa e paguan për telefon, për veturë, për sigurim, për TV, e për çka jo tjetër dhe në mesin e atyre fletëpagesave të shumta të mungon fletëpagesa për obligimin kryesor ndaj vetvetes, ndaj atdheut të robëruar, ndaj farefisit, ndaj dashamirëve e miqëve tu që vuajnë në skamje e në robëri, por që burrisht e timërisht qëndrojnë atje në atdhe. Si s'ke turp pastaj të flasësh për patriotizëm e për atdhedashuri, për lirinë e për ardhmërinë.

Vëllaçko, unë e kam obligim të ta tërheq vëmendjen dhe të të lus që ti t'i kthehesh vetvetes, fëmijëve, familjes, farefisit, bashkatdhetarëve, bashkëkombasëve... T'i kthehesh atdheut. Më beso, vetëm kështu pastaj do ta përjetosh më lehtë barrën e rëndë të dhembjes, të vuajtjes e të mallit si i mërguar.

Ndoshta ti do të pezmatohesh paksa kur ta lexosh këtë artikull. Do të thuash, ndoshta, po ç'i hynë këtij në punë kjo qeshitje. Ndoshta, do të marrësh për të keq, por një gjë më beso. Në të, të jesh i sigurtë, se gjithë këto fjalë t'i thash ngase ta dua të mirën, të dua shumë, po të dua shumë sepse të kam vëlla të dhembjes, të vuajtjes dhe të mallit kurbetçar. Prandaj po të them si vëllau - vëllaut, (e nëse e kam gabim edhe ti duhet të ma thuash në të njëjtën mënyrë) ktheju vetvetes, fëmijëve, familjes, atdheut. Këto janë gjërat më të shenjëta në jetë, vëllaçko po ua ktheve shpinën këtyre, për jetë të jetëve nuk e ke bekimin e atdheut.

E atdheu, atdheu është mbi të gjitha, së paku këtu në mërgim këtë duhet ta kesh shumë të qartë. Atdheu është mbi të gjitha. Ai i ka hak të gjitha... Edhe jetën. Vëllaçko, ke mendjen... Për atdheun duhet të derdhim pandërprerë punë e mund. Dhe atdheu nga ti kërkon vetëm atë që mundesh, vetëm aq sa mundesh. Po s'i realizove ato që mundesh, ti nuk i ke kryer detyrat që t'i ka parashtruar atdheu. Ti s'e ke larë borxhin ndaj atdheut. Dhe borxhet që ia kemi atdheut janë të vogla e të mëdha. Ti nëse nuk e lanë një borxh të vogël, është shumë vështirë të mendojmë se do ta lashë borxhin e madh. Prandaj nisja nga e para, nisja nga fillimi, nga e vogla kah e madhja. Po, po unë kam besim të madh në ty, ti nuk do t'i mbetesh borxh atdheut. Koha është ta dëshmosh këtë vëllaçko; sot me pak, e nesër, ndoshta, edhe më me shumë.